

VENDIM
Nr.111, datë 7.7.2011

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT “PËR HETIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE SHTETËRORE PËR ZBULIMIN, IDENTIFIKIMIN, PËRBALLIMIN, NEUTRALIZIMIN, PENGIMIN DHE NDËSHKIMIN E VEPRIMIT TË ORGANIZUAR KRIMINAL PËR DHUNIMIN E INSTITUCIONEVE DHE PËRMBYSJEN E RENDIT KUSHTETUES NË DATËN 21 JANAR 2011”, TË NGRITUR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR. 82, DATË 23.1.2011

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 8 dhe 9 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e komisionit hetimor të Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Afati i veprimtarisë së komisionit hetimor të Kuvendit “Për hetimin e veprimtarisë së institucioneve shtetërore për zbulimin, identifikimin, përballimin, neutralizimin, pengimin dhe ndëshkimin e veprimit të organizuar kriminal për dhunimin e institucioneve dhe përmbysjen e rendit kushtetues në datën 21 janar 2011”, të ngritur me vendimin e Kuvendit nr.82, datë 23.1.2011, zgjatet për një periudhë 6-mujore, duke filluar nga data e miratimit të këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)